



KONTRATË SHITJEJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 17.12.2019 (dymije e nentembedhete) para meje Noteres Margena Çela, Anetare e Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Tirane, me zyre noteriale ne Njesine nr 7 rruga Astrit Balluku, Pallati Kajtazi, Kati i pare u paraqit personalisht:

PALA SHITËSE: 1. Zoti Alger Osmani, atësia Myrteza, lindur në Skrapar më 05.03.1977 e banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 024433180 me nr. personal **H70305150U**, ortak i shoqërisë "Cela & Associates" sh.p.k (Kodi NUIS L71424021N), Njesia Administrative Nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Ndertesa Nr. 22, Pallati E88, Hyrja 1, që merr pjesë në shoqëri me 33,33 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë;

PALA BLERËSE: 1. Zoti Radovan Cela, shtetas shqiptar, atësia Brahim, lindur më 15.04.1981 në Fier, mbajtës i letërnjoftimit nr. 028668871 me nr. personal I10415087B, ortak i shoqërisë "Cela & Associates" sh.p.k (Kodi NUIS L71424021N), Njesia Administrative Nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Ndertesa Nr. 22, Pallati E88, Hyrja 1, që merr pjesë në shoqëri me 33,33 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë;

2. Ervis Cela shtetas shqiptar, atësia *Perparim*, lindur më 23.09.1984 në Roshnik, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034067450 me nr. personal I40923048Q, ortak i shoqërisë "Cela & Associates" sh.p.k (Kodi NUIS L71424021N), Njesia Administrative Nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Ndertesa Nr. 22, Pallati E88, Hyrja 1, që merr pjesë në shoqëri me 33,33 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë;

OBJEKTI I KONTRATËS: Shitje e 1 kuote e barazvlefshme me 33.33 % të kapitalit që Shitësi zotëron në shoqërinë "Cela & Associates" sh.p.k. (NUIS L71424021N).

BAZA LIGJORE: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

- Zoti Alger Osmani** është ortak i shoqërisë "Cela & Associates" sh.p.k, me seli në Njesia Administrative Nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Ndertesa Nr. 22, Pallati E88, Hyrja 1, Kodi tatimor NUIS: L71424021N, e regjistruar pranë QKB (*Qendrës Kombëtare të Biznesit*), me kapital të shoqërisë prej **300 (treqind)** lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 33,33 % të kapitalit të shoqërisë;
- Zoti Alger Osmani** deklaroi se 1 kuotë të tij në shoqëri (e që përbëjnë një pjesë dhe 33,33 % të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndërmend t'i shesë;
- Zoti Radovan Cela dhe Ervis Cela** kanë shprehur dëshirën e tyre dhe pranojnë të blejnë kuotën që shet zoti Alger Osmani;
- Shoqëria nuk ka ortak tjetër që të ketë të drejtë parablerjeje të kuotave që shet zoti Alger Osmani;
- sipas konfirmimit të marrë nga RBS (*Regjistri i Barrëve Siguruese*), konfirmim që i bashkëlidhet kësaj kontrate, rrjedh se shoqëria nuk ka barrë hipotekore;

Osmani

Cela

Ervis

f) Ky veprim i shitblerjes së kuotave është miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin përkatës.

Sot ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, të dy palët deklarojnë se zoti Alger Osmani shet dhe zoti Radovan Cela dhe Ervis Cela blejnë nga zoti Alger Osmani të 1 kuotë e barazvlefshme me 33,33 % të kapitalit në shoqëri e që deri tani i zotëronte zoti Alger Osmani. Kuotat shiten dhe blihen me çmim sa vlera nominale e tyre, e konkretisht me çmimin total 100 (njqind) lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht jashtë kësaj zyre noteriale: zoti Alger Osmani është paguar nga pala blerëse për vlerën e kuotave që shiten dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë veprim.

Zoti Radovan Cela dhe Zoti Ervis Cela deklarojnë se është njohur me aktet e shoqërisë dhe me gjendjen ekonomike e financiare të saj dhe deklarojnë se si ortakë të shoqërisë përgjigjen sipas ligjit për të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve lidhur me këtë kalim pronësie, përfshirë dhe detyrimet e mëparshme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitblerjeje para meje Noteres, Pala Shitëse e humbet 33,33% mbi ato kuota që shiti në kapitalin e shoqërisë "Cela & Associates" sh.p.k. dhe zotërues i 33,33 % të tyre bëhet zoti Radovan Cela & Zoti Ervis Cela me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky kalim pronësie.

Kuotat blihen e zotërohen nga Blerësi që nga data e sotme.

Pas këtij akti shitblerjeje kuotash, shoqëria e lartpërmendur ka 2 (dy) ortakë dhe pikërisht:

Zotin Radovan Cela, që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të shoqërisë.

Zotin Ervis Cela, që në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 50 (pesedhjetë) % të kapitalit të shoqërisë.

Kjo Kontratë redaktohet në 4 (katër) kopje të barazvlerëshme, ku njëra kopje mbahet nga unë Noterja dhe tri kopjet e tjera u jepen palëve.

Kontrata redaktohet konform neneve 162, 761 e vijues të Kodit Civil, konform ligjit "Mbi Noterinë", konform Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe konform vullnetit të lirë e të plotë të palëve, të cilët, pasi e lexuan përmbajtjen e saj dhe e gjetën atë sipas dëshirës së tyre, e nënshkruajnë atë para meje Noteres pa asnjë vërejtje dhe unë noterja e nënshkruaj rregullisht këtë akt. Bashkëlidhur kësaj kontrate janë dokumentet përkatëse ligjore.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE
Alger Osmani

Alger Osmani
Osmani

PALA BLERËSE

Radovan Cela
Radovan Cela

Ervis Cela

Ervis Cela

NOTERE



REGZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-2019121711750718
Data e Rezultatit te Kerkimit: 17.12.2019
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:07:50AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-204-1831
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ALGER MYRTEZA OSMANI
CELA & ASSOCIATES LAW FIRM SH.P.K.



Valberis Jals